

VENDIM
Nr. 327, datë 18.4.2013

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, e 23 pika 3 të ligjit nr. 9258, datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në fund të shkronjës "A" "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët", shtohen individët e renditur në shkronjën "a" të listës "Lista e shtuar e individëve në listën e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët", që i bashkëlidhet këtij vendimi, si anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për individët që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për talibanët.

2. Në fund të shkronjës "C" "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", shtohen individët e renditur në shkronjën "b" të listës "Lista e shtuar e individëve në listën e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", që i bashkëlidhet këtij vendimi, si anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për individët që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për organizatën Al-Qaida.

3. Nga lista e shkronjës "C", "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", çregjistrohen individët e renditur në shkronjën "c" të listës "Lista e individëve të çregjistruar nga lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", që i bashkëlidhet këtij vendimi, si persona të çregjistruar nga anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për Al-Qaida, me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

a) Lista e shtuar e individëve ne "Lista e individëve anetare ose bashkepunetore me Talibanet.":

1. AHMED SHAH: NOORZAI: OBAIDULLAH;

b) Lista e shtuar e individëve ne "Lista e individëve anetare ose bashkepunetore me organizaten Al-Qaida.":

1. DJAMEL: AKKACHA;

2. ABDERRAHMANE: OULD EL AJVLAR;

3. HAMADA: OULD MOHAMED ELKHAIRY ;

4. IYAD: AG GHALI;

c) Lista e individëve te crregjistruar nga "Lista e individëve anetare ose bashkepunetore me organizaten Al-Qaida.":

1. SULIMAN: HAMD: SULEIMAN: AL-BUTHE;

2. USAMA: MUHAMMED: AWAD: BIN LADEN;

3. MAMOUN 2: DARKAZANLI;

4. ABDELGHANI 2: MZOUDI;